



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr .82, date 2.3.2000

PËR

SHPLLJEN PARK KOMBËTAR NË MBROJTJE TË SHTETIT TE ZONËS

ARKEOLOGJIKE TË BUTRINTIT

Në mbeshtetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen Park Kombëtar në mbrojtje të shtetit, zonën arkeologjike të Butrintit, me sipërfaqe 25 km², të shtrirë në këta kufij gjeografikë: Në veri kufizohet me fshatin Ksamil;

Në jug me lumin e Pavllos, duke anashkaluar Vrinën, drejt fushës dhe duke u futur brenda zonës te liqeni i Bufit;

Në perëndim me gjirin e Butrintit, aty ku kanali i Vivarit derdhet ne det;

Ne lindje me rrugën ekzistuese, që shkon ne Konispol (sipas hartës që i bashkëlidhet vendimit) .

2. Për administrimin e këtij Parku Kombëtar ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, e qytetit antik të Butrintit, njësi nën Juridiksionin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ky vendim nuk cenon afatet e parashikuara për realizimin e projektit turistik brendashkruar kufijve, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta